



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:069240

Datë: 19.05.2023

Numri i dokumentit: 04298947

P.nr.256/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN/Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me bashkëpunëtoren profesionale Kadishe Ajvazi Demi, në çështjen penale ndaj të pandehurve A.H dhe A.H...që të dy nga Gj..., për shkak të veprës penale Dhunë në Familje nga neni 248 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-s), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.509/2023, të datës 25.04.2023, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar jo publik, më datë 12.05.2023, mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **A.H..**, nga babai H.. dhe nëna H..., e gjinisë K..., i lindur më datë ..., në Gj..., me vendbanim në rrugën "M..Gj..", nr..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa martuar, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal ..., me numër të telefonit 043/..., më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale ndaj tij.

I pandehuri **A.H..**, nga babai H.. dhe nëna H..., e gjinisë K..., i lindur më datë ..., në Gj..., me vendbanim në rrugën "M..Gj..", nr... ka të kryer shkollën e mesme, i pa punësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa martuar, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal ..., me numër të telefonit 043/..., më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale ndaj tij.

JANË FAJTOR

Sepse më datë 17.03.2023, rreth orës 18:00, në rrugën "M. Gj." nr.. . si dhe më parë për një periudhë të gjatë kohore, në shtëpinë e tyre familjare, në gjendje të shendetit të reduktuar, kur aftësija e tyre për të kontrolluar veprimet e tyre dhe aftësia e tyre për të arsyetuar kanë qenë të zvogëluara, kanë kryer abuzim psikologjik dhe fizik dhe dhunë ekonomike, ndaj një anëtari të familjes së tyre-nënës së tyre të dëmtuarës H.H., me të cilën jetojnë në një familje të përbashkët, me qëllim të rrezikimit të dinjitetit të saj, duke ushtruar dhunë në familje, në kundërshtim me nenin 2 sipas paragrafit 1.2 të Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje, në atë mënyrë që të pandehurit fillimisht kanë kërkuar nga nëna H.. që t'u jepte para në shumë prej 40 euro për të blerë narkotikë, dhe kur viktimja u ka thënë se nuk kishte, të dyshuarit në mënyrë

agresive dhe fizikisht e kanë sulmuar duke e kapur nga duart, duke e tërhequr zvarrë dhe shtyrë me çka e dëmtuar ka rënë për tokë, nga xhepi i viktimës me dhunë i kanë marrë 40 euro dhe më pas të dyshuarit janë larguar nga shtëpia, dhe pas 20 minutash janë kthyer sërish në shtëpi, kanë hyrë në dhomën e tyre dhe janë mbyllur, dhe pas 30 minuatsh kanë dalë nga dhoma dhe i kanë kërkuar viktimës që t'u japë sërish paratë dhe kur ajo u ka thënë se nuk i ka, prapë janë bërë agresivë dhe kanë tentuar ta sulmojnë sërish, për çka viktima është detyruar të mbyllet në dhomë dhe të lajmërojë policinë, duke i shkaktuar kështu të dëmtuarës frikë dhe shqetësim të madh emocional,

Me çka ka kryer veprën penale Dhunë në Familje nga neni 248 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-s.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 38, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70 të KPRK, si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarit i,

I GJYKON

I. Të pandehurit **A.H.**, për veprën penale Dhunë në Familje nga neni 248 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-s, i caktohet dënimi kumulativ:

- **dënim me gjobë në shumë prej 1200 (njëmijë e dyqind) euro**, i cili dënim do të ekzekutohet, në afat prej 30 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe,
- **dënim me burg në kohëzgjatje prej 120 (njëqind e njëzetë) ditë**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.

II. Të pandehurit **A.H.**, për veprën penale Dhunë në Familje nga neni 248 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i caktohet dënimi kumulativ:

- **dënim me gjobë në shumë prej 1200 (njëmijë e dyqind) euro**, i cili dënim do të ekzekutohet, në afat prej 30 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe
- **dënim me burg në kohëzgjatje prej 120 (njëqind e njëzetë) ditë**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.

III. Konform nenit 79 të KPRK-s, të pandehurve A.H dhe A.H...koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 17.03.2023 deri me datën 12.05.2023 do të ju llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobë.

IV. Nëse të akuzuarit refuzojn të paguajn dënimin me gjobë ose nuk janë në gjendje ta paguajn atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtim me të akuzuarit zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme ashtu që 8 (tetë) orë të punës do të barazohen me 20.00 € (njëzet euro) ndërsa nëse të akuzuarit nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimin me gjobë në punë në dobi të përgjithshme atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20.00 € (njëzet euro) do të ju caktohet një ditë burgim.

V. Obligohen të akuzuarit që veq e veq të paguajn taksën për Kompensimin e Viktimave të krimit në shumë prej nga 20.00 (njëzetë) euro, në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

VI. Obligohen të akuzuarit që veq e veq të paguajn shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, në shumën prej nga 20.00 € (njëzetë euro), në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

ARSYETIM

1. Rriedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 04.04.2023, ka ngritur Propozimin për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim PP.II.nr.509/2023, kundër të pandehurve A.. dhe A.H., nga Gjiilani, për shkak të veprës penale Dhunë në Familje nga neni 248 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-s. Por pasi që eksperti i psikiatrisë ka deklaruar se të pandehurit në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia mendore e tyre nuk ka qenë e zvogluar esencialisht dhe pasi që gjykata ja ka kthyer Propozimin në plotësim, Prokuroria me datë 25.04.2023 ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.509/2023, të datës 25.04.2023 ndaj të pandehurve A.H.. dhe A.H..

Në shqyrtimin fillestar jo publik të datës 12.05.2023, prezent ishin prokurorja e shtetit Leonora Kadriu, të pandehurit A.H.. dhe A.H., me mbrojtësit e tyre av.Amir Rudaku dhe av.Hazir Haziri, e dëmtuara H.H., në të cilën seancë të pandehurit pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorës së shtetit kanë deklaruar se e pranojnë fajësinë për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, të dëmtuarës dhe mbrojtësve, konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 242 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, prandaj ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurve A.H.. dhe A.H., për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohen, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se të pandehurit e kanë kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se të pandehurit nuk kanë qenë të detyruar as të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj veprë, ekziston fakti se të pandehurit A.H.. dhe A.H., kanë kryer veprën penale dhunë në familje nga neni 248 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve lidhur me dënimin, ka shpallur fajtor të akuzuarit A.H.. dhe A.H., për shkak të vepres penale dhunë në familje nga neni 248 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-s, ngase veprimet e të njëjtëve i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën janë dhe penalisht përgjegjës.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenin 69,70 të KPRK-s, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe të njëjtëve t'u shqiptohet dënim si në dispozitiv të aktgjykimit, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, ashtu që për të akuzuarit A.H.. dhe A.H., si rrethanë lehtësuese ka marrë faktin se e dëmtuara nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale, të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohen, se të pandehurit janë penduar, dhe i kanë kërkuar falje

të dëmtuarës, i kanë premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti se të njëjtit kanë shkaktuar frikë tek e dëmtuara-nëna e tyre dhe rrezikshmërinë shoqërore si dhe përgjegjësinë penale.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënim i shqiptuar ndaj të akuzuarve A.H.. dhe A.H., duke marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-s, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale, gjykata, duke u bazuar nenin 452 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurit ti detyrojë secilin veq e veq për ti paguar shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësor, si dhe taksën për kompensimin e viktimave të krimit sipas ligjit (LIGJI NR. 08/L-109), të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 256/2023, më datën 12.05.2023**

Bashkëpunëtore profesionale,
Kadishe Ajvazi Demi

Gjyqtari,
Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE; Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të përgjithshëm në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.